



This project is funded by the European Union



Green Economy for Advanced Region

“KODI I GJELBER”, Berat



#KOMPOSTODHETI





This project is funded by the European Union



” PËR BERATIN SI PASURI E IMJA DHE E UNESCO-S.”

UDHËZUES PËR KOMPOSTIMIN





This project is funded by the European Union



Çfarë është komposti?




- Komposti është një material si humusi, i errët dhe i pasur me një shumëllojshmëri ushqyesish, minerale dhe organizma të dobishme të tokës. Ai mund të përdoret në kopshte, oborre apo saksi për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm dhe të mirë-ekuilibruar të tokës për bimët që duam të rrisim. Në shumë raste, komposti mund të përdoret në vend të plehrave komerciale dhe është shumë më efikas në ofrimin e ushqyesve për bimën në mënyrë të qëndrueshme. Ai gjithashtu përmirëson vetitë fizike dhe biologjike të tokës në një mënyrë që plehrat komerciale nuk mund ta bëjnë. Pikërisht për këto arsye kopshtarët apo fermerët i referohen kompostit si “ari i zi”.



This project is funded by the European Union

Çfarë është komposti?

- Ka shumë përkuzime për kompostin ose plehun organik, por ai që haset më së shumti e përcakton Kompostin si pleh organik pa erë ose me erë të pranueshme, të qëndrueshëm në kohë, të pasur me humus, i aftë që të lëshojë në tokë lëndë ushqyese, të përmirësojë strukturën e tokës duke ndihmuar qarkullimin e ajrit.
- Ai ofron mikroorganizma të dobishëm për kulturat e mbjella, dhe nxit rritjen e aparatit të tyre rrënjor.





This project is funded by the European Union



- *Arsyet e KOMPOSTIMIT*
- Për të promovuar politika inovative të menaxhimit të praktikave mjedisore ne promovimë KOMPOSTIMIN.
- Problemet mjedisore janë të lidhura me ndikimin e aktiviteteve njerëzore mbi burimet mjedisore. Këto ndikime ndotin tokën duke e bërë riparimin e tyre është shumë të vështirë.
- Njeriu është një nga prodhuesit më të mëdhenj të mbeturinave të krijuara në tokë, ndaj praktikat tona të menaxhimit mjedisor ofrojnë alternativa për reduktimin e mbeturinave.
- Kompostimi është një depozitim alternativ i mbetjeve organike dhe mund të jetë pjesë e çdo programi komunitar për menaxhimin e mbetjeve.





- Për të ulur mbetjet që gjenden ngado, duke i dhënë një imazh të ri turizmit.
- Programet e kompostimit janë shumë të thjeshta për t'u realizuar në komunitete rurale, në vend të vendosjes së tarifave të larta për transportin dhe menaxhimin e mbetjeve.
- Materialet që riciklojmë, kontribuojnë dhe zvogëlojnë sasinë e mbeturinave duke:
 - 1) zvogëluar kontributin financiar të pushtetit vendor si taksë/kg mbetje në fushë depozitë dhe 2) kontribuojnë në zvogëlimin e ndojtjes së mjedisit



- Cfarë mund të kompostojmë
- Kompostimi I letrës dhe materialeve të kartonit të cilat nuk mund të mblidhen veçmas e të çohen në pikat e grumbullimit të specializuar (për arsye ekonomike, mungese të kompanive mbledhëse etj.
- Mbetjet e njoma (ose të gjelbërta) Të shpejta për tu kalbur, ofrojnë azot dhe lagështirëbar i korrur; ? perime të papjekura; ? lëkura frutash apo fruta të prishura; ? qese çaji; ? llum kafeje; ? barëra të këqija;





This project is funded by the European Union



Cfarë mund të kompostojmë ?

- Mbetjet e thata (ose kafe) Të ngadalta për tu kalbur, ofrojnë fibra dhe karbon, krijon mundësi e ajrosjes: gjethe të thata; kashtë; lëkurë vezësh; letër ose karton; bukë; oriz, brumra; tallash.
- *Mos kompostoni asnjëherë!*
- mish, peshk dhe kocka; bimë të sëmura; jashtëqitjet e kafshëve shtëpiake qen e mace; vaj e produkte qumështi; produkte e tallash të trajtuara me kimikate; ferrat (ato janë të qëndrueshme dhe nuk para dekompozohen kollaj);





This project is funded by the European Union



Green Economy for Advanced Region

Cfarë mund të kompostojmë ?

- SAKTËSIM TERMASH
- Materialet e pasura me azot njihen ndryshe mbetjet e njoma (ose të gjelbëra) dhe janë shpesh të freskëta dhe jeshile si bari, mbeturinat e të korrave, mbetjet ushqimore, bajgat, mbetjet e kafesë etj.
Materialet e pasura me karbon quhen ndryshe mbetjet e thata (ose kafe) dhe janë zakonisht substanca drurore, gjethet e thata, kashtë etj.





This project is funded by the European Union



Cfarë mund të kompostojmë ?

- Si funksionon kompostimi? Kompostimi njihet më së shumti si procesi aerobik i cili shpërbën biologjikisht materialet në prani të oksigjenit (ajrit). Nënproduktet kryesore të tij janë dioksidi i karbonit, uji dhe nxehtësia.
- Kompostimi mund të jetë edhe proces anaerobik ku shpërbërja ndodh në mungesë të oksigjenit. Në këto raste nënproduktet kryesore janë metani, dioksidi i karbonit dhe disa alkoole dhe acide organikë të dobët. Kompostimi aerobik është më eficient, më i thjeshtë dhe shoqërohet me më pak nënprodukte të padëshirueshme.
- Procesi bazik i kompostimit përfshin 5 hapa:
1)përgatitja e materialit të kompostueshëm; 2) kompostimi; 3)kurimi; 4) kontrolli dhe depozitimi;



This project is funded by the European Union



Green Economy for Advanced Region

Sa kohë merr kompostimi?

- Koha që nevojitet nga fillimi i përzierjes së materialit deri në produktin e qendrueshëm zakonisht merr 60-120 ditë.
- Megjithatë 90 ditë mendohet të jetë koha më e përshtatshme për përfundimin e procesit.
- Sa më e madhe të jetë sasia e materialeve organike për t'u kompostuar aq më shumë kohë do të na duhet për të ngritur vendin e përshtashëm. Në momentin që ju e filloni procesin do t'ju duhen vetëm 4-8 orë pune në javë për kontrollin, lëvizjen e materialit etj.





This project is funded by the European Union

Activities of "GREEN CODE":



- Teknikat e kompostimit
- Pavarësisht faktit që kompostimi është përdorur prej vitesh, sidomos nga fermerët, teknikat apo mënyrat e përdoruara për kompostimin janë të pakta dhe jo të standardizuara. Pilotohen metoda të reja, inovatore të cilat mundohen të adoptohen në ambjente të ndryshme si shkolla, qendra të mëdha shërbimi, institucione etj. Gjithsesi për fokusin tonë ne do të shpjegojmë tre teknikat bazë të aplikueshme në rastin e zonave rurale. Paletat Vend dekompozimet e ajrosura (individuale) Vend dekompozimet e ajrosura (të tre – katër fishta)




This project is funded by the European Union



Paletat

- Në këtë teknikë kompostimi, materiali i kompostueshëm vendoset në rreshta paralel të ndarë nga hapësira të konsiderueshme. Paletat zakonisht bëhen në hapësira të pambuluara dhe bazohen në kombinimin e ajrosjes natyrore me përzierjen mekanike për të siguruar kushtet aerobike.
- Avantazhet: e lehtë për tu realizuar; trajton një sasi të konsiderueshme lënde organike; nuk ka nevojë për eksperiencë.





This project is funded by the European Union




Vend dekompozimet e ajrosura (individuale)

- Në këtë teknikë të thjeshtë e cila mund të adoptohet thuajse në çdo oborr, materialet e kompostueshme të thata dhe të njoma (të vendosura me shtresa mundësisht, ose të përziera mirë) lihen në procesin e dekompozimit përrreth 1 muaj dhe pastaj fillohet procesi i përzierjes për të mundësuar ajrosjen.

- *Avantazhet:*

Shumë e lehtë për tu realizuar në kushte shtëpie apo arë; nuk ka nevojë për makineri përzierëse apo paisje të kushtueshme; nuk ka nevojë për eksperiencë.





This project is funded by the European Union



Vend dekompozimet e ajrosura (të tre – katër shta)

- Kjo teknikë është e njëjtë me teknikën e mësipërme, vetëm shtohet numri i binave të ajrosura në mënyrë që të lehtësojë dhe përmirësojë procesin e lëvizjes dhe ajrimit. Në këtë teknikë mbushet një herë binaja e parë dhe me lëvizjen e materialit në binanë e dytë, binaja e parë është e gatshme për të pëlluar një mbushje të re.
- Avantazhet: e lehtë për t'u realizuar në kushte ngastre, are; nuk ka nevojë për makineri përzierse apo paisje të kushtueshme; nuk ka nevojë për eksperiencë; ofron mundësinë e trajtimit të një sasive të konsiderueshme lënde organike dhe në mënyrë të vazhdueshme.



This project is funded by the European Union



DISAVANTAZHET E TEKNIKAVE

- **PALETAT:** Disavantazhi kryesor është hapsira që kërkon e cila është e madhe; në mot të ftohtë ka nevojë për mbulim që të ruajë temperaturën; mund të prodhojë erë të keqe.
- **Vend dekompozimet e ajrosura (individuale)** Disavantazhi kryesor është sasia e limituar që trajtohet; përzierja duhet të kryhet me dorë.
- **Vend dekompozimet e ajrosura (të tre – katër shta) :** disavantazhi kryesor është nevoja për përzierje me krah pune. Në rastet e zmadhimit të binave, përdorimi i mjeteve është i mundshëm për ta eliminuar këtë disavantazh. mund të prodhojë erë të keqe.



This project is funded by the European Union



Kujdes !

- Për të realizuar kompostimin janë shumë të rëndësishme mbetjet e pasura me azot dhe ato të pasura me karbon. Mikroorganizmat përgjatë kompostimit përdorin karbonin si burim energjie dhe azotin për sintezën proteinike.
- Një raport i mirë karbon/ azot (C:N) që siguron një dekompozim eficient është 30 pjesë karbon me 1 pjesë azot në peshë (kujdes kjo i referohet jo volumit të kërkuar, por përbërjes kimike). Kur kemi pak azot të pranishëm atëherë dekompozimi do të ndodhë më ngadalë; nëse kemi më shumë azot, atëherë do të kemi më shumë amonjak të lëshuar në atmosferë i cili shoqërohet me erë më të keqe. Për të arritur një raport të mirë pa shumë lodhje e përlllogaritje, në kushtet e kompostimit individual, apo me sasi të vogla mjaftohuni me këtë rregull: “dy porcione me materiale të pasura me azot të përzier me një porcion me materiale të pasura me karbon”



This project is funded by the European Union



Projekti mbështetet nga Qendra EDEN- Qendra për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim

GEAR, Berat 2020

